

VENDIM
Nr. 449, datë 3.7.2024

**PËR RREGULLAT E DETAJUARA PËR REGJISTRIMIN E KIMIKATEVE NGA
PRODHUESIT DHE IMPORTUESIT, DETYRIMET PËR TË RAPORTUAR NË
REGJISTRIN ELEKTRONIK TË KIMIKATEVE, SI DHE MIRËMBAJTJEN E
REGJISTRIT TË KIMIKATEVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 4, të nenit 27, të ligjit nr. 27/2016, “Për menaxhimin e kimikateve”, dhe të nenit 4, të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Objekt i këtij vendimi është përcaktimi i rregullave të detajuara:
 - a) për regjistrimin e kimikateve nga prodhuesit dhe importuesit;
 - b) për të raportuar në Regjistrin Elektronik të Kimikateve;
 - c) për mirëmbajtjen e regjistrit të kimikateve.
2. Përveç përkufizimeve të dhëna në ligjin në fuqi për menaxhimin e kimikateve, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:
 - a) “**Administrator**”, Zyra e Kimikateve, e cila është njëkohësisht edhe përdoruese e regjistrit të kimikateve në nivel qendror;
 - b) “**Dhënës të informacionit**”, në kuptim të këtij vendimi, janë prodhuesit, importuesit, përdoruesit profesionalë dhe eksportuesit e kimikateve;
 - c) “**Subjekte të interesuara**”, në kuptim të këtij vendimi dhe në kuptim të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, “Për bazën e të dhënave shtetërore”, që kanë akses në bazën e të dhënave me të drejta sipas roleve përkatëse janë:
 - i. struktura përgjegjëse për hartimin e politikave në fushën e kimikateve nën ministrinë përgjegjëse për mjedisin;
 - ii. Shërbimi i Toksikologjisë Klinike në QSUT;
 - iii. Instituti i Shëndetit Publik;
 - iv. struktura përgjegjëse inspektuese në fushën e mjedisit;
 - v. inspektorati shtetëror përgjegjës për tregtinë;
 - vi. inspektorati shtetëror përgjegjës për industrinë;
 - vii. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave;
 - viii. autoritetet përgjegjëse për regjistrimin e kimikateve, si: produktet e mbrojtjes së bimëve, produktet biocide dhe produktet plehëruese, në përputhje me legjislacionin e tyre specifik.Subjektet e interesuara janë subjektet, që aksesojnë në nivel “përdorues” regjistrin e kimikateve.
 - ç) “**Të dhëna parësore**”, sipas kuptimit në ligjin nr. 10325, datë 23.9.2010, “Për bazën e të dhënave shtetërore”;
 - d) “**Të dhëna dytësore**”, sipas kuptimit në ligjin nr. 10325, datë 23.9.2010, “Për bazën e të dhënave shtetërore”;
 - dh) “**Ndërveprim**”, sipas kuptimit në ligjin nr. 10325, datë 23.9.2010, “Për bazën e të dhënave shtetërore”;
 - e) “**Zyra e Kimikateve**”, sipas kuptimit në nenin 6, të ligjit 27/2016, “Për menaxhimin e kimikateve”;
 - ë) “**Përdoruesi profesional**”, çdo person fizik ose juridik, i cili përdor kimikatet për qëllime të përpunimit, të formulimit, përzierjes, rimbushjes në kontejnerë, transferimit nga një kontejner në një tjetër dhe i vendos ato në tregun shqiptar nën emrin e tij a markën e tij tregtare.

II. RREGULLAT PËR REGJISTRIMIN E KIMIKATEVE NGA PRODHUESIT DHE IMPORTUESIT

1. Prodhuesit dhe importuesit kanë detyrimin të regjistrojnë në Regjistrin Elektronik të Kimikateve (në vijim “Regjistri”), të krijuar pranë Zyrës së Kimikateve, të dhënat e kimikateve, të cilat prodhohen apo importohen në Republikën e Shqipërisë, sipas pikës 3, të këtij kreu.

2. Përjashtimisht, të dhënat e kimikateve, sipas pikës 4, të këtij kreu, për produktet për mbrojtjen e bimëve, produktet plehëruese dhe produktet biocide regjistrohen nga autoritetet përgjegjëse, sipas legjislacionit specifik të tyre në fuqi.

3. Afatet për regjistrimin e të dhënave për kimikatet fillojnë:

a) nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, për subjektet që importojnë/prodhojnë kimikate në sasi më shumë se 100 tonë në vit;

b) një vit pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi, për subjektet që importojnë/prodhojnë kimikate në sasi më shumë se 10 tonë në vit deri në 100 tonë në vit;

c) 2 (dy) vjet pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi, për subjektet që importojnë/prodhojnë kimikate në sasi më shumë se 1 ton në vit deri në 10 tonë në vit.

4. Të dhënat për kimikatet që regjistrohen në Regjistrë janë të dhëna parësore dhe të dhëna dytësore:

4.1. Të dhënat parësore janë:

a) të dhënat për identifikimin e kimikatit/produktit që përmban kimikate;

b) të dhënat për kontaktet e furnizuesit, sipas dokumentit me të dhënat e sigurisë së kimikatit (në vijim “MSDS”), si: adresa e plotë fizike, numri i telefonit të furnizuesit, si dhe një adresë *e-mail*-i e një personi kompetent përgjegjës për MSDS-në. Nëse furnizuesi nuk ka vendndodhje në Republikën e Shqipërisë, ku substanca ose përzierja vendoset në treg dhe ai ka emëruar një person përgjegjës në vend, do të jepet adresa e plotë dhe numri i telefonit i atij personi përgjegjës;

c) kodi i kimikatit sipas Nonmenklaturës së Kombinuar të Mallrave (NK) në rastin kur kimikati eksportohet apo importohet;

ç) përbërja/informacioni mbi përbërësit;

d) informacioni për përdorimet përkatëse të identifikuara të substancës ose të përzierjes dhe përdorimet që nuk këshillohen;

dh) ngjyra/t gjendja/et fizike e/të përzierjes/kimikatit, siç ofrohet, dhe pH (aty ku është e aplikueshme);

e) informacioni për përdorimin (konsum të përgjithshëm, profesional, industrial ose një kombinim i ndonjë prej të treve);

ë) informacioni për klasifikimin dhe etiketimin (piktogramet e rrezikut, fjalët sinjalizuese, deklaratat e rrezikut dhe deklaratat parandaluese);

f) informacioni toksikologjik për përgjigje ndaj emergjencave. Ky informacion duhet të jetë në përputhje me seksionin 11, të MSDS-së së produktit, nëse aplikohet ose seksionin 11, të shtojcës II, të vendimit nr. 9, datë 9.1.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për rregullat e detajuara dhe metodat për kryerjen e vlerësimit të sigurisë së kimikatit, si edhe kërkesat specifike, përmbajtja dhe formati i dokumentit me të dhënat e sigurisë”.

g) sasia e prodhuar, e importuar, e eksportuar e kimikatit për vitin paraardhës dhe sasia stok e magazinuar;

gj) informacioni për sigurinë kimike, në rastin e përzierjeve kimike, që ofrohet nga prodhuesit/importuesit/përdoruesit profesionalë, që vendosin në treg përzierjet, me qëllim hartimin/përgatitjen e masave parandaluese dhe kurative, veçanërisht në rastet e përgjigjeve të emergjencave shëndetësore. Informacioni për sigurinë kimike përfshin informacionin për rrezikun në shëndetin njerëzor, informacionin për rrezikun fiziko-kimik, informacionin për rrezikun në mjedis, informacionin për qëndrueshmërinë, bioakumulimin, toksicitetin (QBT) dhe shumëqëndrueshmërinë dhe shumëbioakumulimin (SHQSHB), sipas pikës 3, të kreut III, të vendimit nr. 9, datë 9.1.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për rregullat e detajuara dhe metodat për

kryerjen e vlerësimit të sigurisë së kimikatis, si edhe kërkesat specifike, përmbajtja dhe formati i dokumentit me të dhënat e sigurisë” .

4.2. Të dhëna dytësore janë:

a) të dhënat e regjistrit tregtar për emrin, numrin unik të identifikimit, adresën dhe statusin për subjektet, që prodhojnë, importojnë kimikate në territorin e Republikës së Shqipërisë, objekt i regjistrimit të kimikateve, sipas nenit 27, të ligjit nr. 27/2016, “Për menaxhimin e kimikateve”;

b) të dhënat për produktet e mbrojtjes së bimëve, që regjistrohen në përputhje me vendimin nr. 335, datë 6.6.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave për regjistrimin, të procedurës dhe kriterëve të vlerësimit të produkteve për mbrojtjen e bimëve”;

Informacioni që sigurohet nga autoritetet janë të dhënat e certifikatës së regjistrimit, sipas përcaktimeve të kreut VI, të vendimit nr. 335, datë 6.6.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave për regjistrimin, të procedurës dhe kriterëve të vlerësimit të produkteve për mbrojtjen e bimëve”, përfshirë MSDS-në, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 27/2016, “Për menaxhimin e kimikateve”.

c) Të dhënat për produktet biocide, që sigurohen nga autoritetet përgjegjëse, të cilat autorizojnë vendosjen në tregun shqiptar të tyre. Informacioni që sigurohet nga autoritetet përgjegjëse, janë të dhënat sipas shkronjës “b”, të pikës 1, të kreut III, të vendimit nr. 933 datë 25.11.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e rregullave për kriteret e vlerësimit të produkteve biocide dhe të procedurës së dhënies së autorizimit të vendosjes së tyre në treg”;

ç) Të dhënat për produktet plehëruese, sipas shkronjës “ç”, të nenit 8, të ligjit nr. 17/2020, “Për produktet plehëruese”.

5. Baza e të dhënave administrohet, mirëmbahet e përditësohet nga Zyra e Kimikateve.

6. Baza e të dhënave të Regjistrit Elektronik të Kimikateve ndërvepron me të dhënat për produktet e mbrojtjes së bimëve, produktet plehëruese dhe produktet biocide, që sigurohen nga autoritetet përgjegjëse, që autorizojnë vendosjen e tyre në tregun shqiptar të tyre.

7. Baza e të dhënave ndërvepron nëpërmjet Platformës Qeveritare të Ndërveprimit me Bazën e të Dhënave të Regjistrit Tregtar.

8. Niveli i aksesimit nënkupton:

a) aksesimin në nivel qendror ose në atë të “administratorit”, ku përfshihen administratori/ët i/e regjistrit në Zyrën e Kimikateve. Niveli i aksesimit dhe funksionet e të drejtat për secilën kategori përdoruesi të sistemit janë në përputhje me pozicionin e punës së punonjësit të Zyrës së Kimikateve;

b) aksesimin në nivel “dhënës të informacionit”, sipas përcaktimit në shkronjën “b”, të pikës 2, të kreut I, të këtij vendimi;

c) aksesimin në nivel “përdorues”, sipas përcaktimit në shkronjën “c”, të pikës 2, të kreut 1, të këtij vendimi.

III. DETYRIMET PËR TË RAPORTUAR NË REGJISTRIN ELEKTRONIK TË KIMIKATEVE

1. Importuesit, prodhuesit, përdoruesit profesionalë dhe eksportuesit raportojnë të dhënat për kimikatis, që importohen, prodhohen, përdoren në vend apo eksportohen jashtë Republikës së Shqipërisë. Përgjashtimisht, të dhënat për produktet për mbrojtjen e bimëve, produktet plehëruese dhe produktet biocide, që importohen, prodhohen apo eksportohen, raportohen nga autoritetet përgjegjëse, sipas legjislacionit specifik të tyre në fuqi.

2. Përgjashtohen nga detyrimi për raportim të dhënat, për:

a) kimikatis, sipas përcaktimeve të pikave 2 dhe 4, të nenit 4, të ligjit nr. 27/2016, “Për menaxhimin e kimikateve”;

b) kimikatis, që importohen ose prodhohen në territorin e Republikës së Shqipërisë në sasi më të vogël se 100 kg për vit për çdo subjekt importues apo prodhues;

c) kimikatis, që përdoren për studime dhe hulumtime shkencore, të cilat nuk vendosen në treg, por përdoren në mënyrë të kontrolluar, në përputhje me legjislacionin specifik për kushtet në mjediset e punës dhe mjedisin.

3. Subjektet dhe autoritetet e përcaktuara në pikën 1 të këtij kreu, raportojnë në Regjistrin Elektronik të Kimikateve, nëpërmjet portalit unik qeveritar “*e-Albania*”, me anë të shërbimit elektronik “Regjistrimi i kimikateve”, brenda datës 31 mars të vitit vijues, për sasinë e prodhuar, të importuar, të eksportuar të kimikateve për vitin e kaluar dhe të dhënat sipas nënpikave 4.1 dhe 4.2, të kreut II, të këtij vendimi, për kimikatet që regjistrohen për herë të parë në këtë regjistër. Për kimikatet që shoqërohen me dokumentacionin me të dhënat e sigurisë, sipas nenit 15, të ligjit nr.27/2016, “Për menaxhimin e kimikateve”, informacioni i raportuar të jetë në përputhje me atë dokumentacion.

4. Administratori harton raportin vjetor të detajuar për kimikatet e regjistruara, i cili është pjesë e raportit për gjendjen e mjedisit, që përgatitet nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (në vijim “AKM”).

5. Raportimi i Regjistrit nga administratori bëhet 1 (një) herë në vit pranë INSTAT-it, sipas standardit kombëtar të statistikave zyrtare dhe sa herë që kërkohet nga persona të interesuar, duke u mbështetur në legjislacionin për të drejtën për informim.

IV. MIRËMBAJTJA E REGJISTRIT TË KIMIKATEVE

1. Regjistri Elektronik i Kimikateve mirëmbahet dhe administrohet nga Zyra e Kimikateve si institucioni administrues, në kuptim të ligjit nr. 27/2016, “Për menaxhimin e kimikateve”.

2. Përdoruesit e Regjistrit Elektronik të Kimikateve, sipas shkronjës “c”, të pikës 8, të kreut II, të këtij vendimi, ruajnë konfidencialitetin dhe besueshmërinë e këtyre të dhënave personale, në përputhje me nenin 28, të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar.

V. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Ngarkohen ministria përgjegjëse për mjedisin, ministria përgjegjëse për bujqësinë, ministria përgjegjëse për shëndetësinë, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Shërbimi i Toksikologjisë Klinike në QSUT, Instituti i Shëndetit Publik, struktura përgjegjëse inspektuese në fushën e mjedisit, inspektorati shtetëror përgjegjës për tregtinë dhe inspektorati shtetëror përgjegjës për industrinë, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit për zbatimin e këtij vendimi.

2. Struktura përgjegjëse inspektuese në fushën e mjedisit është institucioni përgjegjës për kontrollin e plotësimit të detyrimeve për regjistrimin e kimikateve nga prodhuesit dhe importuesit, në përputhje me dispozitat e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet pas vënies në funksion të sistemit elektronik për regjistrimin e kimikateve.

KRYEMINISTËR
Edi Rama